



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 55 datë 7.11.2022

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2022 E MIRATUAR ME “VKB NR 3,
DATË 05.01.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR” DHE DETAJIMIN E FONDIT TE ALOKUAR PER
EMERGJENCAT CIVILE PER VITIN 2022”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 23 pika 54 germa “dh” të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratime procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” neni 3,3.1, gërmat a,b,dh, ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji nr.68/2017 ‘Për financat vendore’, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “mbi procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit’, i ndryshuar, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 10.01.2022 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, shkresës nr. 6937/1 datë 28.04.2022 të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit “Dërgohet miratimi për rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile, për vitin 2022”, shkresës nr.1007/1 prot, datë 17.06.2022 “Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022” të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, VKB nr. 3, datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar ,

VKB Nr. 46 datë 27.09.2022 të Këshillit Bashkiak Shkodër, Shkresën Nr. 658/I prot “ Mbi Vendimin Nr . 46 datë 27.09.2022 të Këshillit Bashkiak Shkodër , së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

I. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet, të cilëve u janë dëmtuar banesat nga zjarri si më poshtë:

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z.Miri Kraja** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 246 956 (dyqind e dyzetgjashtëmije e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë,dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 199 880 (nëqind e nentëdhjetë e nentemije e teteqind e tetëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, përfamiljen e **z. Miri Kraja** , sipas tabelës nr. 1.

2. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 329 date 16.05.2012 ,të humbjes së jetës së anëtarit të familjes si pasojë e fatkeqësisë e djegies së banesës nga zjarri familjes së **z.Bledar Vujoshi** (një anëtarë familje), në vlerën 500 000 lekë (peseqindmije) sipas tabelës nr. 1 .

3. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Bledar Vujoshi** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 670 974 (gjashtëqind e shtatëdhjetemije e nentëqind e shtatëdhjetë e kater) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 353 180 (treqind e pesëdhjetë e tremije e njëqind e tetëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, përfamiljen e **z. Bledar Vujoshi**, sipas tabelës nr. 1.

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Fatmir Bushaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 850 860 (njemilion e teteqind e pesëdhjetemije e teteqind e gjashtëdhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 484 060 (katerqind e tetëdhjetë e katermije e gjashtëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Fatmir Bushaj** , sipas tabelës nr. 1.

5. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Muhamet Hysaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 296 502 (njemilion e dyqind e nentëdhjetë e gjashtëmije e peseqind e dy) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 427 300 (katerqind e njetet e shtatëmije e treqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Muhamet Hysaj** , sipas tabelës nr. 1.

6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z.Veli Bushaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 2 342 476 (dymilion e treqind e dyzet e dymije e katerqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej

427 300 (katerqind e njezet e shtatemije e treqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, përfamiljen e z.Veli Bushaj , sipas tabelës nr. 1.

7. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e z. Nike Guri në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 885 372 (njemilion e teteqind e tetedhete e pesemije e treqind e shtatedhete e dy) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 420 860 (katerqind e njezetmije e teteqind e gjashtedhete)lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.Nike Guri , sipas tabelës nr. 1 .

8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e z.Vasil Guri në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 835 648 (njemilion e teteqind e tridhete e pesemije e gjashteqind e dyzet e tete) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 415 360 (katerqind e pesemjedhjetemije e treqind e gjashtedhete) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.Vasil Guri , sipas tabelës nr. 1.

Tabela e përfitimit sipas dëmeve .

Tabela

nr.1

Nr	Emri familjes	Vlera ndërtimore 1	Vlera e orendive 2	Vlera ndërtimore dhe e orendive 2+3	50 % Vlera ndërtimore 4	50 % Vlera e orendive 5	50 % Vlera ndërtimore dhe e orendive 4+5	Humbja e jetës 6	Dëmshpërblim për humbje jete 7
1	Miri Kraja	246 956	199 880	446 836	123 478	99 940	223 418	-	-
2	Bledar Vujoshi	670 974	353 180	1 024 154	335 487	176 590	512 077	1	500 000
3	Fatmir Bushaj	1 850 860	484 060	2 334 920	925 430	242 030	1 167 460	-	-
4	Muhamet Hysaj	1 296 502	427 300	1 723 802	648 251	213 650	861 901	-	-
5	Veli Bushaj	2 342 476	427 300	2 769 776	1 171 238	213 650	1 384 888	-	-
6	Nike Guri	1 885 372	420 860	2 306 232	942 686	210 430	1 153 116	-	-
7	Vasil Guri	1 835 648	415 360	2 251 008	917 824	207 680	1 125 504	-	-
	Shuma përfundimtare	10 128 788	2 727 940	12 856 728	5 064 394	1 363 970	6 428 364	1	500 000

II. Të miratojë fondin gjëndje për përballimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri në masën 50% të vlerës së dëmit për raste të paparashikuara gjatë vitit 2022 si dhe për situata të paparashikuara për emergjence civile gjatë vitit 2022 në shumën **1,026,999 lekë** në aktivitetin P03280.O1.A2. “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie” (Pr. 10910 kod i Ministrise), sipas tabelës nr. 2 .

III. Planifikimin e aktivitetit P03280.O1.A5 “Ndërhyrje Emergjente për riaftësimin e segmentit ‘Guri Mashter – Breg Lumi’” (Pr. 10910 kod i Ministrise) në shumën **8,600,000 lekë** sipas tabelës nr. 2

IV. “Blerje stabilizanti” në shumën **1,600,000 lekë** , sipas tabelës nr. 2 .

V. “Blerje thasë rëre për mbrojtje nga përmbytjet” në shumën **300,000 lekë** , sipas tabelës nr. 2

DETAJIMI I FONDIT TRANSFERTË E KUSHTËZUAR NË VLERËN 29,695,583 lekë.

Tabela nr 2

NR	EMERTIMI	VLERA/lekë	FAZA
1.	Dhënie e ndihmës financiare për vlerat ndërtimore dhe orendive për kompensimin në masën 50% të vlerës së dëmit për familjet, të cilëve u janë dëmtuar banesat nga zjarri	11,240,220	Miruar me VKB nr.46 date 27.09.2022
2.	Dhënie e ndihmës financiare për vlerat ndërtimore dhe orendive për kompensimin në masën 50% të vlerës së dëmit për familjet, të cilëve u janë dëmtuar banesat nga zjarri dhe trajtimi me ndihmë financiare për një rast humbje jete të anëtarit të familjes nga zjarri.	6,928,364	P/VENDIM
3.	Fondi gjëndje për përballimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri në masën 50% të vlerës së dëmit për raste të paparashikuara si dhe për situata të paparashikuara për emergjence civile gjatë vitit 2022	1,026,999	P/VENDIM
4.	Ndërhyrje Emergjente për riaftësimin e segmentit ‘Guri Mashter-Breg Lumi’.	8,600,000	P/VENDIM
5.	“Blerje stabilizanti”	1,600,000	P/VENDIM
5.	‘Blerje thasë dhe rëre’	300,000	P/VENDIM

	SHUMA	29,695,583	
--	-------	------------	--

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Leska

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 8.11.2022